

Nebi Bardhoshi (1977–) Prof. as. dr. Nebi Bardhoshi, është drejtues i departamentit të etnologjisë pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë. Bardhoshi është kërkues shkencor pranë ish-Institutit të Kulturës Popullore, sot Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit që nga viti 2002. Nga viti 2015 e këtej, prof. as. dr. Bardhoshi është *researcher fellow*, në *Graduate School for East and Southeast European Studies*, Regensburg, Gjermani, si dhe *visiting profesor*, në universitetin e Regensburgut, për lëndën *Property and Anthropology of law* (2017). Bardhoshi ka eksperiencë mësimdhënieje në universitete të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë, në lëmin e etnologjisë, antropologjisë sociale, antropologjisë së të drejtës, antropologjisë së drejtësisë.

Fushat kryesore të interesit shkencor të këtij autori janë antropologjia e së drejtës, antropologji e pronës dhe antropologji e shtetit. Në vitin 2011, botoi librin *Gurtë e Kufinit: kanuni, prona, strukturimi social*, (2011, UET-Press), i cili u prit mjaft mirë nga kritika.

Në vitin 2015, Bardhoshi vjen me monografinë e tij të dytë me titull *Antropologji e kanunit*, botim i parë nga Qendra e Studimeve Albanologjike Tiranë dhe ribotim në vitin 2016, nga shtëpia botuese “*Pika pa Sipërfaqe*”, Tiranë.

Bardhoshi është bashkeditor i vëllimit *Social Practices and Local Reconfiguration in the Balkans* (2013). Ky edicion është produkt i projektit ndërkombëtar BALKABAS, “Les Balkans par le bas”, që u përfitua nga programi “Jeunes chercheurs” de l’Agence nationale de la recherche (ANR) de janvier 2009 à juin 2012 (ANR-08-JCJC-0091).

Bardhoshi është gjithashtu autor i një serie artikujsh që kanë në fokus proceset sociale e kulturore të të jetuarit në kushtin e pluralitetit ligjor, legjitimitetin e së drejtës, raporteve mes së drejtës, pronës e strukturës sociale, antropologjisë së fiseve, kujtesës sociale, studime në lëmin e antropologjisë urbane.

Një interes më specifik, Bardhoshi ka mbi historinë e mendimit antropologjik e, posaçërisht në shqyrtimin e raporteve të dijes me pushtetin në etnologjinë shqiptare gjatë periudhës komuniste dhe post-komuniste. Për këtë çështje, Bardhoshi ka marrë pjesë në konceptimin e projektit *Studiues e Studime*, projekt i departamentit të etnologjisë, Tiranë. Në bashkautorësi me studiuesin Olsi Lelaj, ka përfunduar monografinë (2017), *Etnografia shqiptare në situatën diktatoriale: dija, shteti dhe holokausti ynë*.

Ekspeditat etnografike, Bardhoshi i ka realizuar në Shqipëri, Kosovë, Greqi, Mal i Zi. Në zonat kufitare Shqipëri-Kosovë (2002, 2003, 2004, 2005, 2008, 2009, 2010). Në vitin 2004, realizoi një ekspeditë informative në zonën e Kurbinit, përkatësisht në fshatrat Gur i Bardhë dhe Gallatë, mbi çështje të pronës, kujtesës sociale, imazhit të shtetit. Në vitin 2011–2012, realizoi kërkime etnografike në Mal të Zi, përkatësisht në zonën e Krajës dhe Shestanit, kryesisht me çështjen e kujtesës sociale, lidhjes me tokën dhe varret, në zona të braktisura nga njerëzit. Në vitin 2014, në kuadër të projektit *Trupa të shënjuar, shpirtra të harruar*, Bardhoshi realizoi kërkime në terren mbi/dhe në Metalurgjikun e Elbasanit. Për këtë, u realizua dokumentari *Trupa të shënjuar, shpirtra të harruar* (2014). Në vitin 2007, 2011, 2013, në zonën kufitare Shqipëri–Greqi, përkatësisht në Përmet dhe Leskovik.

Krahas zonave rurale dhe kufitare, Bardhoshi ka realizuar dhe vijon të realizojë një seri kërkimesh etnografike në zonat periferike të Tiranës (ndryshe të njohura si zona informale). Ndërkaq, pjesë e kësaj strategjie kërkimore janë bërë dhe gjithë politikat qeveritare mbi "Rilindjen Urbane" dhe ato për muzeifikimin e së shkuarës komuniste. Për këtë, Bardhoshi ka konceptuar projektin *Shteti në skaje*, projekt, i cili ka në qendër të analizës proceset shndërruese në lëmin e kulturës ligjore dhe politike në zonat e njohura si informale. Ndërkaq, pjesë e kësaj strategjie kërkimore janë bërë dhe politikat qeveritare mbi "Rilindjen Urbane" dhe ato për muzeifikimin e së shkuarës komuniste.

Bardhoshi është bashkorganizator i seminarit permanent *Përthyerje Antropologjike*, që realizohet në bashkëpunim mes departamentit të etnologjisë (IAKSA) dhe Bibliotekës Kombëtare, Tiranë, që nga maji i vitit 2016. Gjithashtu, Bardhoshi është bashkorganizator i *Laboratorit të Antropologjisë Vizuale*, që mbahet në Prizren, dhe që realizohet nga bashkëpunimi i Departamentit të Etnologjisë me Doku-Fest, Prizren.